

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. 18/2013**  
**Prishtinë**  
**24 prill 2013**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga  
Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit,  
Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe  
Gjyqtari i Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,  
Në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. **G. XH.** 1988 në
2. **V. J.**

Të dytë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në vijim:

- a) **Kryerja e veprave terroriste** sipas nenit 110 paragrafit 1 në lidhje me nenin 109 paragrafin 1 pikën 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së),
- b) **Pjesëmarrja në grupet terroriste** sipas nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së dhe
- c) **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** sipas nenit 328 të KPK-së.

3. **Q. R.**
4. **M. A.**

Të dytë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në vijim:

- a) **Organizimi, përkrahja dhe Pjesëmarrja në grupet terroriste** sipas nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së dhe
- b) **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** sipas nenit 328 të KPK-së.

Pas ankesës fajësia është vërtetuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës kurse dënimi është ndryshuar duke rezultuar në dënimin për veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë më 12.4.2007 me 11 vite dhe për veprën penale Mbajtja në

pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve me 6 muaj, me dënim unik prej 11 viteve dhe 4 muajve burgim;

Duke vendosur ë lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur më 7 shkurt 2013 nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPShK-së) kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Pn.-Kr. 1/2013, të datës 7 janar 2013 dhe aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Pn.-Kr. 167/2013, të datës 1 shkurt 2013,

lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur më 7 shkurt 2013 nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Pn.-Kr. 1/2013, të datës 7 janar 2013 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit Pn.-Kr. 167/2013, të datës 1 shkurt 2013, është E BAZUAR.**

**Gjykata Supreme e Kosovës KONSTATON SE VENDIMET E KUNDËRSHTUARA PËRMBAJNË SHKELJE TË LIGJIT në lidhje me llogaritjen e periudhës së vazhdimit të paraburgimit dhe arrestit shtëpiak. PERIUDHA E VAZHDIMIT TË MASËS DUHET TË LLOGARITET NGA DATA E SKADIMIT TË PERIUDHËS SË URDHËRUAR MË HERËT.**

### ARSYETIM

#### I. Historia relevante e procedurës

Më 1 korrik 2012, katër të pandehurit janë arrestuar nën dyshimin për përfshirjen e tyre në sulmet e 17 majit 2012 dhe 28 qershorit 2012 në stacionin e policisë në Bujonc në Serbi dhe për aktivitete e tyre të dyshimta si pjesëtarë të së ashtuquajturës "Lëvizjes për Liri".

Më 2 korrik 2012 gjyqtari i procedurës paraprake në Gjilan ka vendosur paraburgimin kundër të pandehur **G.X.H.** dhe **V.J.** në periudhë prej një muaji.

Pas ankesës së Prokurorit të EULEX-it, kolegji nrei tre gjyqtarëve i Gjykatës së Oarkut në Gjilan ka vendosur dy të pandehurit e tjerë **M.A.** dhe **Q.R.** në arrest shtëpiak për një muaj deri më 4 gusht 2012.

Masat përkatëse kundër të pandehurve të lartpërmendur janë vazhduar vazhdimisht.

Me aktvendimin PP. 63/12 të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan të datës 27 dhjetor 2012, paraburgimi kundër C. G. XH. dhe V. J. është vazhduar prej 30 dhjetorit 2012 deri më 30 janar 2013.

Me aktvendimin PP. 63/12 të kolegjit prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan të datës 27 dhjetor 2012, arresti shtëpiak kundër M. A. dhe C. Q. është vazhduar prej 30 dhjetorit 2012 deri më 30 janar 2013.

Më 7 janar 2013, pas ankesave të paraqitura nga avokatët mbrojtës të tre të pandehurve, kolegji i Gjykatës së Apelit me aktvendimin Pn.-Kr. 7/2013 ka ndryshuar sipas detyrës zyrtare dy aktvendimet e lartpërmendura të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan në lidhje me llogaritjen e datave prej dhe deri më të vazhdimin të masave. Në lidhje me të dy aktvendimet, Gjykata e Apelit ka llogaritur periudhën e vazhdimin nda dita e vendimit, nga data 27 dhjetor 2012 deri më 27 janar 2013.

Me aktvendimin PPr. 63/12 e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan të datës 23 janar 2013, paraburgimi kundër C. G. XH. dhe V. J. dhe arresti shtëpiak kundër M. A. dhe C. Q. është vazhduar prej 23 janarit 2013 deri më 23 shkurt 2013, si duhet në netodës së kalkulimit të pohuar në aktvendimet e mëparshme të Gjykatës së Apelit.

Pas ankesës, Gjykata e Apelit me aktvendimin Pn.-Kr. 167/13, të datës 1 shkurt 2013 ka vërtetuar aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Gjiilan.

Më 7 shkurt 2013, Prokurori i Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit Pn.-Kr. 7/13<sup>1</sup>, të datës 7 janar 2013 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan PP. 63/12, të datës 23 janar 2013, dhe aktvendimit Pn.-Kr. 167/13 të Gjykatës së Apelit të datës 1 shkurt 2013.

Sipas nenit 435 paragrafit 2 të KPP-së, kërkesa e ZPShK-së i është dorëzuar palëve kundërshtare. Shkresat e lëndës nuk përmbajnë asnjë përgjigje.

## II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

### 1. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme.

Sipas nenit 433 paragrafëve 1 dhe 2 të KPP-së, është paraqitur nga pala e autorizuar dhe brenda afatit ligjor. Paraqitësi i kërkesës ka interes legjitim në përcaktimin e metodës së drejtë të llogaritjes për vazhdimin e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak.

Të dy vendimet e kontestuara janë të formës së prerë në kuptim të nenit 432 paragrafit 1 të KPP-së. Nuk ka kufizime ligjore kundër kontestimit të dy vendimeve me një mjet juridik.

<sup>1</sup> Sigurisht kërkesa gabimisht i referohet 'PN/KR 1/13' kurse përmend datën e saktë 7 janar 2013.

## 2. Procedurat e ndjekura nga Gjykata Supreme

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë siç është përcaktuar me nenin 435 paragrafin 1 të KPP-së.

## 3. Meritat e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Paraqitësi i kërkesës ka kundërshtuar aktvendimet e përmendura mbi bazën e shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 në lidhje me nenin 370 paragrafin 6 dhe nenin 384 paragrafin 2 nën-paragrafin 1 të KPP-së. Ai i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që të përcaktojë që aktvendimet e kontestuara nuk kanë pasur arsyetim adekuat, se përmbajnë shkelje të nenit 191 dhe nenit 183 të KPP-së në lidhje me vazhdimin e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak dhe periudha e vazhduar për të dy masat fillon nga data e skadimit e caktuar me aktvendimin e mëparshëm dhe jo nga data e vendimit të gjykatës kompetente mbi vazhdimin e masës.

Pas përmbajtjes së kërkesës dhe sipas nenit 438 paragrafit 1.3 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës është kufizuar vetëm në konstatimin e ekzistimit të shkeljes së ligjit.

Gjykata e Apelit ka përmendur si bazë për metodën e saj të llogaritjes së vazhdimin të masës duke filluar nga data e vendimit të gjykatës se neni 285 paragrafët 1, 3 dhe 4 si dhe neni 278 paragrafi 7 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) e përcaktojnë një parim të tillë. Aktvendimet e kundërshtuara i referohen nenit 3 paragrafit 2 të KPP-së, sipas Gjykatës së Apelit nga disa interpretime të mundshme të dispozitave ligjore kërkohet që të aplikohet dispozita më e favorshme për të pandehurin.

Aktvendimeve të kundërshtuara i mungon arsytimi i qëndrueshëm për llogaritjen e vazhdimin të paraburgimit dhe arrestit shtëpiak.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Gjykata e Apelit gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 3 paragrafin 2 në faktet aktuale në fjalë. Dispozita e përmendur në mënyrë të qartë i referohet vetëm 'fakteve relevante' dhe 'dispozitave të ligjit penal' kurse në përgjithësi është e pranueshme se nuk është e zbatueshme ndaj dispozitave të procedurës penale. Parimet '*in dubio pro reo*' dhe supozimi i pafajësisë janë të zbatueshme vetëm në ligjin penal material, siç është reflektuar në formulimin e dispozitës ligjore.

Dispozitat e nenit 285 paragrafëve 1, 3 dhe 4 (ngjashëm me nenin 191 të KPP-së) si dhe nenin 278 paragrafin 7 të KPPK-së (ngjashëm me nenin 183 paragrafin 7 të KPP-së) nuk përcaktojnë se periudha e vazhdimin të një mase të llogaritet duke filluar nga data e vendimit përkatës dhe jo nga data e skadimit të periudhës së caktuar me aktvendimin e mëparshëm.

Përkundrazi, do të ishte jo logjike nëse një aktvendim mbi vazhdimin e paraburgimit apo arrestit shtëpiak të caktuar më parë do të kishte efektin e shfuqizimit të periudhës së mbetur të masës së caktuar me aktvendimin e mëparshëm. Periudha e përcaktuar me aktvendimin e mëparshëm mbetet në fuqi edhe në rast të marrjes së vendimit mbi vazhdimin e periudhës para skadimit të periudhës së mëparshme. Kjo në fakt është procedurë standarde siç është përcaktuar me nenin 191 paragrafin 2 të KPP-së (paraprakisht neni 285 paragrafi 2 i KPPK-së), i cili kërkon që procedura për vazhdimin e masës të fillohet para datës së skadimit të saj. Kjo është arsyetuar me nevojën që t'i mundësohet të gjitha palëve që të dëgjohen me kohë dhe me domosdoshmërinë e përgatitjes së vendimit të arsyetuar mbi vazhdimin para skadimit të periudhës së caktuar më parë.

Ky interpretim gjithashtu mbështetet me nenin 190 paragrafin 1 të KPP-së (i cili korrespondon me nenin 284 paragrafin 1 të KPPK-së), i cili bën llogaritjen e periudhës së paraburgimit nga data e arrestimit e jo nga data e aktvendimit.

Cilado metodë tjetër e llogaritjes së periudhës së vazhdimin do të çonte në shkurtimin e kufijve të paraburgimit secilën herë që gjykata do të vazhdonte masën në kundërshtim të nenit 190 paragrafit 2 të KPP-së.

Gjykata pajtohet me argumentin e ZPShK-së se ekzistimi i arsyeve për paraburgim apo arrest shtëpiak janë vlerësuar me anë të aktvendimit të fundit mbi caktimin apo vazhdimin e masës për periudhën e plotë kohore. Prandaj, nëse gjykata ka kërkuar që të vazhdohet masa do të thotë se këto arsye vazhdojnë të ekzistojnë, nuk ka nevojë të vërtetohen përsëri për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së periudhës së masës. Masa duhet të vazhdohet duke filluar nga data e skadimit për periudhën e caktuar kohore.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si në dispozitiv në bazë të nenit 438 paragrafit 1.3 të KPP-së.

**Kryetar i kolegjit**

**Procesmbajtës**

---

Martti Harsia  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. 18/2013**  
**PRISHTINË**  
**24 prill 2013**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. 18/2013**  
**Prishtinë**  
**23 maj 2013**

Gjyqtari i EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. C. S. XH. fsni 112.
2. V. V. D. ne 2. mbajtja në grupet terroriste sipas nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së dhe v. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 të KPK-së. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 të KPK-së.

Të dytë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në vijim:

- a) **Kryerja e veprave terroriste sipas nenit 110 paragrafit 1 në lidhje me nenin 109 paragrafin 1 pikën 10 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së),**
- b) **Pjesëmarrja në grupet terroriste sipas nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së dhe**
- c) **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 të KPK-së.**

3. C. S. XH. fsni 112.
4. M. A. Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 të KPK-së.

Të dytë të dyshuar për kryerjen e veprave penale në vijim:

- a) **Organizimi, përkrahja dhe Pjesëmarrja në grupet terroriste sipas nenit 113 paragrafit 3 të KPK-së dhe**
- b) **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 të KPK-së.**

Duke vepruar sipas detyrës zyrtare sipas nenit 371 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së) lëshon këtë:

## AKTVENDIM

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl.-Kzz. 18/2013, i datës 24 prill 2013, korrigohej si në vijim:

Paragrafi i parë në faqen dy (2) i aktgjykimit në gjuhën angleze (versioni në gjuhën shqipe: paragrafi i fundit i cili fillon në faqen një (1) dhe mbaron në faqen dy (2)), i cili fillon me “Pas ankesës...” dhe mbaron me “...11 vjet dhe 4 muaj burgim” (versioni në gjuhën shqipe: fillon me “Pas ankesës...” dhe mbaron me “...11 viteve dhe 4 muajve burgim”), fshihet.

## ARSYETIM

### I. Historia relevante e procedurës

Aktgjykimi në fjalë është lëshuar më 24 prill 2013 dhe i është dërguar palëve më apo pas 21 majit 2013.

Aktvendimi aktual korrigjon sipas detyrës zyrtare një gabim të qartë dhe të parëndësishëm shkrimi në aktgjykim sipas nenit 371 paragrafit 1 të KPP-së.

Ky aktvendim së bashku me versionin e korrigjuar të aktgjykimit do t'i dërgohet palëve në procedurë sipas nenit 371 paragrafit 3 të KPP-së.

**Kryetar i kolegjit**

**Procesmbajtës**

---

Dr. Horst Proetel  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Pkl.-Kzz. 18/2013**  
**PRISHTINË**  
**23 maj 2013**